



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.06.2019, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe votimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2018”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Besnik Baraj, Dritan Bici, Eglantina Gjermani, Gjetan Gjetani, Ilir Beqaj, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Rrahman Rraja, Kujtim Gjuzi, Zef Shtjefni dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Ilir Ndraxhi dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Viojmë me çështjen e dytë të rendit të ditës: miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2018”.

Në mos gabo, relatore ka qenë zonja Gjermani?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, zoti Pëllumbi është këtu për çdo pyetje.

Arben Pëllumbi – Teksti është shpërndarë.

Niko Peleshi – Duhet ta lexoj, apo e kanë marrë të gjithë tekstin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, meqenëse të gjithë e keni tekstin përpara, rekomandimet do t’i lexojë zoti Pëllumbi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zoti Pëllumbi për rekomandimet, për të kaluar më pas në votimin e projektrezolutës.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Po kaloj direkt te rekomandimet.

Për pjesën se çfarë kemi vlerësuar në raportin e ERE-s, të gjithë kolegët e kanë përpara. Ka nga dy ndryshime, redaktime, për të cilat kemi rënë dakord edhe me kolegët që na asistojnë. Kështu që më lejoni të filloj direkt me rekomandimet e Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2019:

- Të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për marrjen e masave të nevojshme për monitorimin e ndarjes së “OSHEE sh.a-së”, sipas parashikimeve ligjore që janë paraqitur.

- Të luajë një rol proaktiv për rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore respektive gjatë periudhës transitorie për bërjen efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

- Të vijojë bashkëpunimin me aktorët e mandatuar për operimin dhe monitorimin e Bursës së Energjisë dhe, njëkohësisht, të japë opinion për studimin që do të kryhet nga ministria lidhur me vlerësimin e impaktit afatshkurtër, sepse një rritje e mundshme e çmimit të energjisë mund të ketë efekt te klientët familjarë, dhe masat që duhen marrë për amortizimin e këtij efekti te klienti fundor.

- Të propozojë ndryshimet e nevojshme pranë ministrisë për zbatimin e kërkesave të certifikimit të operatorëve të transmetimit, në përputhje me opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

- T'i kushtojë një vëmendje të veçantë implementimit të planit të masave nga "OSHEE sh.a" në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe përditësimit të tij në funksion të problematikave që kanë dalë përgjatë zbatimit të tij.

- Të punojë bashkë me aktorët e tjerë, nga njëra anë, për nxitjen e investimeve në impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si: centralet fotovoltaike, eolike, biomasave e të tjera, investime të cilat sjellin edhe një diversifikim gradual të prodhimit të energjisë dhe, nga ana tjetër, të bashkëpunojë me ministrinë në përgatitjen e kuadrit ligjor dhe rregullator për thithjen e tyre, në uljen e kostove apo edhe në shpërndarjen e drejtë të tyre tek të gjithë klientët.

- Të bashkëpunojë me ministrinë dhe të bëjë një vlerësim për menaxhimin e riskut hidrologjik, në mënyrë që të menaxhohen risqet e rritjes së kostove të furnizimit të energjisë elektrike për klientët fundorë, për shkak të kushteve klimatike, si dhe të konsiderojë mundësinë e krijimit të një fondi garancie nga KESH-i me përfitimet financiare të nxjerra gjatë një viti hidrologjik të mirë, të cilat mund të kompensojnë riskun financiar të një viti hidrologjik jo të mirë.

- T'i kushtojë vëmendje të veçantë, në vijim të vitit 2019, implementimit të strukturës së miratuar dhe rekrutimit të një stafi sa më të aftë profesionalisht, si dhe trajnimit të tyre për përballimin e sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së punës dhe pavarësisë operationale të ERE-s.

- Të vazhdojë punën së bashku me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë për marrjen e vendimeve dhe nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse për projektin TAP dhe krijimin e kushteve për hapjen e tregut të gazit natyror në vendin tonë, në përputhje me direktivën përkatëse të BE-së.

- Të japë opinion për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe atë të Financave dhe Ekonomisë për gjetjen e rrugëve dhe zgjidhjeve për shuarjen e detyrimeve reciproke midis operatorëve publikë të sektorit të energjisë elektrike.

- Të punojë për hartimin e një strategjie për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë, në përputhje me direktivën e BE-së "Për sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike", duke përfshirë në listën e këtyre infrastrukturave edhe infrastrukturat e kompanisë publike të gjenerimit apo dhe impiantet private të gjenerimit.

- Të bëjë vlerësimet e propozimeve të paraqitura nga OSHEE-ja pas përfundimit të studimit të vlerësimit të humbjeve të energjisë elektrike në traktin e lidhjes nga njësia gjeneruese deri në pikën e lidhjes me rrjetin e OSHEE-së, lidhur me humbjet e OSHEE-së prej pikës së lidhjes së prodhuesve të energjisë.

- Të kërkojë nga OSHEE-ja që pas shtyrjes së afateve të përcaktuara në rregulloren “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, OSHEE-ja të kërkojë një aplikim të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarde të performancës në zona të ndryshme.

- Të caktojë afate konkrete për OSHEE-në lidhur me vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit, të paktën në disa projekte pilot të identifikuar nga vetë OSHEE-ja, i cili lehtëson në mënyrë të ndjeshme leximin e matjes së energjisë dhe krijon opsione të reja të mundshme, duke përfshirë edhe leximin periodik disamujor, si dhe, në përfundim të konsultimeve me palët e interesit, aty ku kushtet teknike të kompanisë e lejojnë, të sigurojë përfshirjen në kontratën tip për vitin 2019 të kësaj mënyre leximi të sistemit të matjes.

- Të kërkojë nga OSHEE-ja që, në periudhë afatshkurtër, të mundësojë lidhjen në rrjetin e shpërndarjes së impianteve fotovoltaike në ndërtesa, si dhe nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, që është një prioritet i përcaktuar edhe në ligjin përkatës.

- Të vijojë punën për mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet kompetencave që i jep ligji: mosrespektimi i afateve për shërbimet përkatëse, sjelljet arbitrare dhe të papërgjegjshme ndaj klientëve, që vijnë në mbeten një problem me gjithë uljen e numrit të ankesave pranë ERE-s.

- Të kërkojë nga OSHEE-ja anulimin e faturimeve të klientëve të energjisë elektrike, të cilët janë faturuar me faturimin nën emertimin “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” në periudhën tetor 2008 – prill 2011. Me gjithë vendimin e deritanishëm të ERE-s, problemi vijon të mbetet i pazgjidhur.

Në bashkëpunim me OSHEE-në dhe institucionet përgjegjëse, i rekomandojmë ERE-s të mbështesë propozimet për dhënien e një zgjidhjeje të problemit të pronësisë së kabinave elektrike, 51,3% e të cilave nuk janë në pronësi të OSHEE-së, duke krijuar kështu pengesa për të drejtën e ndërhyrjes dhe kryerjen e shpenzimeve financiare nga ana e OSHEE-së në rastet e nevojshme, si dhe të japë opinion nëse ndryshimet në legjislacion janë të nevojshme për zgjidhjen e këtij problemi në të ardhmen.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Ka ndonjë koment?

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Le t'i kthehemi pak paragrafit të tretë të pjesës së rekomandimeve. Po e lexoj: “Të vijojë bashkëpunimin me aktorët e mandatuar për operimin dhe monitorimin e Bursës së Energjisë dhe njëkohësisht të japë opinion për studimin që do të kryhet nga ministria lidhur vlerësimin e impaktit afatshkurtër të një rritjeje të mundshme të çmimit të energjisë”. Sugjeroj që këtë paragraf ta mbarojmë të fjalë e parë “Bursës së Energjisë” dhe të vëmë pikë! Pse? Sepse ERE-ja nuk mund të japë opinion paraprak për një gjë, të cilën do të duhet ta shprehë me vendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bën një studim? Shkon aplikon dikush për një çmim të rritur? ERE-ja shprehet me vendim për këtë çmim. Prandaj nuk mundemi t'i themi ERE-s: jep një opinion paraprak për një gjë, për të cilën ne me ligj i kemi thënë se duhet të shprehet me vendim.

Niko Peleshi – Pra, mendoni që fjalinë ta mbyllim te fjalët...

Ilir Beqaj – Mendoj që paragrafi i tretë të jetë kështu: “Të vijojë bashkëpunimin me aktorët e mandatuar për operimin dhe monitorimin e Bursës së Energjisë”, kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse ne i themi: jep mendim për një gjë, që, në fakt, me ligj duhet të shprehet kur të japë vendimin për çdo rritje çmimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për çfarë e bën ministria studimin? Në mënyrë që pastaj të shkojë të kërkojë çmim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur t'i vijë studimi, e analizon dhe në fund shprehet me vendim: po ose jo. Pra, nuk mund t'i kërkojmë të japë opinion paraprak për një studim, për të cilin duhet të shprehet me vendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ka ndonjë propozim tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Zef Shtjefni – Ndërhyrjen e kam më shumë për një sqarim.

Në rekomandimin e parafundit thuhet: “Të kërkojë nga OSHEE-ja anulimin e faturimeve të klientëve të energjisë elektrike, të cilët janë faturuar me faturimin nën emertimin “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” në periudhën tetor 2008 - prill 2011”, pra në një kohë kur ka qenë një qeveri tjetër.

A mund të ma shpjegoni pak si është ky problem? Si ka ndodhur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thuhet: “Energji e pamatur”.

Ilir Beqaj – Në atë kohë ka pasur fatura që kanë pasur këto dy shënime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush ka qenë në qeveri në atë kohë?! Në fund të fundit, njerëzit kanë paguar më shumë se sa duhet dhe ERE-ja e ka marrë një vendim se ky ka qenë një veprim..., ama pasoja te njerëzit nuk është neutralizuar ende. Për këtë aspekt flasim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zef Shtjefni – Vendimi i ERE-s nuk është reflektuar te konsumatori.

Ilir Beqaj – Ende nuk është reflektuar.

Tani, pse ka qenë vendim i një qeverie tjetër, kjo nuk ka rëndësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e ka marrë ERE-ja vendimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zef Shtjefni – Pse nuk e ka zbatuar? Ka pasur kohë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – ERE-ja nuk zbaton, por thjesht merr vendimin, të cilin e zbatojnë operatorët e tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndoshta duhet të insistojë në vazhdimin e zbatimeve të vendimeve të veta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka problem.

Arben Pëllumbi – Ne si komision i sugjerojmë ERE-s çfarë duhet të bëjë për vitin tjetër. Ajo ka një vendim të saj që nuk po e zbaton. Pra, ne i sugjerojmë që të vazhdojë zbatimin e vendimit të saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Jo, mor, ia kemi dhënë si rekomandim edhe një vit tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është realizuar?! Kaq kemi ne si deputetë: t’i themi ERE-s ta ndjekë këtë punë; ky është kontrolli parlamentar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe çështjen e kabinave ia kemi thënë vitin e kaluar, ia themi edhe këtë vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky, pra, është kontrolli parlamentar që bëjmë, se ai është ent i pavarur!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po të ishte kështu, nuk kishte komision, merrte vendim qeveria dhe “Hajt, shnet!”.

Niko Peleshi – Kemi ndonjë propozim të artikuluar se çfarë duhet shtuar, duhet hequr ose duhet ndryshuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Më falni, edhe një herë, ne vetëm rekomandojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shtjefni, ju lutem, mos na u drejto sikur jemi qeveria, ne jemi deputetë të gjithë. Edhe ERE-ja është një institucion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, meqenëse nuk ka ndonjë propozim tjetër, kush është dakord me miratimin e draftrezolutës me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi në proces votimi. Më vjen keq!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Po të dalësh në terren në zona të veçanta, pas vitit '90 janë ndërtuar disa linja private, të cilat janë pothuajse jashtë rregullave teknike. Të paktën nga konstatimi im në zonën time janë 4-5 linja të tilla.

Tani ka një kontradiktë ndërmjet OSHEE-së dhe këtyre privatëve. Ato janë jashtë kushteve teknike, OSHEE-ja u merr paratë dhe ato paguajnë për konsumin e energjisë elektrike. Mirëpo nuk ndërhyjnë më për t'i riparuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam ngritur këtë problem tek OSHEE-ja, tek ERE-ja, te Këshilli Teknik, por nuk ka gjetur zgjidhje ende. Mendoj se nga ne i duhet sugjeruar ERE-s, Këshillit Teknik dhe OSHEE-së që t'i marrë këto linja në zotërim, pasi privatët nuk investojnë më. Ato linja mund të jenë edhe rrezik për jetën e njerëzve, pasi janë jashtë kushteve teknike dhe gjithmonë njerëzit ankohen për energjinë elektrike.

Kështu që do të thosha që t'i hapim rrugën OSHEE-së për t'i marrë në mbikëqyrje këto linja, t'i ketë nën kontrollin e saj derisa mbledh lekët e faturimeve për energjinë elektrike, që harxhojnë banorët, që i kanë ndërtuar këto linja private.

Propozoj që në relacion të shtohet që OSHEE-ja t'i marrë nën mbikëqyrje të gjitha linjat e ashtuquajtura private, që nuk i ka në inventarin e saj.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Jam dakord me sugjerimin që bëri kolegu Sinaj. Në fakt, ne shqyrtuam vetëm problemin e kabinave, por është e njëjta situatë.

Ne folëm për një pronë private të ndërtuar nga privatët, por që administrohet nga OSHEE-ja dhe kjo e fundit nuk ndërhyr dot për investime të caktuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, propozimi im është: “Në bashkëpunim me OSHEE-në dhe institucionet përgjegjëse të mbështesë propozimet për dhënien e një zgjidhjeje të problemit të pronësisë së kabinave elektrike, 51,3% e të cilave nuk janë në pronësi të OSHEE-së, si dhe të disa linjave të transmetimit po në pronësi private, duke krijuar kështu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Të gjejmë një shprehje të saktë për linjat e transmetimit, Marlind, se mos transmetimi është si OST-ja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të bëjmë një saktësim se për çfarë lloj linje konkrete bëhet fjalë.

Arben Pëllumbi – Ndërkohë, zoti kryetar, më duket me vend edhe ndërhyrja e zotit Beqaj për ta hequr këtë pjesën këtu, duke e lënë fjalinë deri te “monitorimin e Bursës së Energjisë” dhe për pjesën tjetër ne nuk ndërhyjmë në raportet që ata kanë me njëri-tjetrin për këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Kush është dakord me të dyja propozimet e integruara të zotit Beqaj për paragrafin e tretë, që përfundon te rreshti i parë “Bursës së Energjisë” dhe të hiqet pjesa vijuese e paragrafit të tretë, ndërkohë paragrafi i fundit të riformulohet sipas propozimit të zotit Pëllumbi, duke kënaqur edhe shqetësimin e ngritur nga zoti Sinaj?

Kush është dakord me draftrezolutën, me këto përmirësime?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet draftrezoluta.

Faleminderit të gjithëve dhe punë të mbarë në vazhdim!

MBYLLET MBLEDHJA